

DEKLARATË E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

MBI MUNGESËN E KONSULTIMIT DHE TRANSPARENCËS SË

POZICIONIT NEGOCIUES TË SHQIPËRISË

Javën e kaluar, më 15 tetor, u mbajt Konferenca e Dytë Ndërqeveritare midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, e cila shënoi çeljen e negociatave të anëtarësimit për kapitujt themelorë. Kjo ngjarje u mirëprit nga aktorët vendas, të cilët shprehën gatishmërinë e tyre për të mbështetur përbushjen e zotimeve.

Në kuadër të negociatave, Shqipëria dhe BE-ja paraqitën pozicionet e tyre negociuese për grupkapitullin e parë, të cilët përcaktojnë kritere specifike dhe angazhime konkrete në fushat e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit, funksionimit të gjyqësorit dhe ekonomisë së tregut.

Megjithatë, ndryshe nga pozicioni negociues i BE-së i cili u [publikua](#) më datë 15 tetor, Qeveria shqiptare vazhdon ta konsiderojë “konfidencial” pozicionin negociues të Shqipërisë. Në këto kushte, organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri shprehin shqetësimin dhe keqardhjen për mungesën e transparencës dhe konsultimit të institucioneve qeveritare me aktorët vendas.

Shoqëria civile, rrethet akademike, media dhe komuniteti i biznesit duhet të luajnë të gjithë një rol kyç në formësimin dhe zbatimin e reformave të nevojshme për anëtarësimin në BE. Publikimi i pozicionit negociues të Shqipërisë është parakusht thelbësor për të mundësuar përfshirje të aktorëve vendas, si edhe monitorim të pavaruar të përpjekjeve të qeverisë shqiptare për zbatimin e detyrimeve dhe përbushjen e kritereve të anëtarësimit.

Procedura e përshpejtuar dhe konfidenciale në të cilën u shqyrtua pozicioni negociues i Shqipërisë nga ana e Kuvendit ngre shqetësime të mëtejshme të cilat dëmtojnë besimin publik dhe kredibilitetin e procesit të negociatave me BE-në.

Ne, organizatat e shoqërisë civile, i bëjmë thirrje qeverisë që ta shfrytëzojë këtë moment si një mundësi për reflektim dhe ndryshim. Është thelbësore që fazat e integritit evropian të trajtohen si një përpjekje e përbashkët që përfshin të gjithë aktorët vendas në një dialog kuptimplotë dhe transparent.

Vetëm përmes një bashkëpunimi të hapur dhe gjithëpërfshirës me aktorët vendas, Shqipëria mund të arrijë ndryshimet transformuese të nevojshme për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

ORGANIZATAT NËNSHKRUERE

- › Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
- › Qendra ALERT
- › Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
- › Instituti i Kërkimeve Urbane (URI)
- › Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri - Child Rights Centre Albania (CRCA)
- › Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë në Shqipëri / Albanian National Child Helpline
- › Akademia e Integritimit Europian dhe Negociatave (AIEN)
- › Qendra ALTRI - Albanian Legal and Territorial Research Institute
- › Shoqata "Together for Life"
- › Faktoje
- › Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)
- › Save the Children in Albania
- › Shoqata për Kulturë Demokratike
- › Qendra Impakt Inkubator
- › Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN)
- › EU Policy Hub
- › Shoqata "Useful to Albanian Woman"
- › Qendra për të Drejtat në Punë - CRL
- › Qendra për Drejtësi Gjinore
- › Fondacioni "Harriet Martineau"
- › Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF)
- › Albanian Woman in Audiovisual- AWA
- › Rrjeti i Profesionistëve të Rinj
- › Albanian Center for Economic Research - ACER